

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot

Korçë më ____ .08.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbikëqyrja e punimeve me objekt: “Ndërtim ujësjetllës dhe nënobjekte të furnizimit me ujë dhe përmirësim rrjetesh ekzistuese në Rajonin Korçë.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mbikëqyrja e punës së ndërtimit 71247000-1.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.104.567,17 (dy milion e njëqind e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3, me vlerë 42 091 (dyzet e dy mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 841.826 Lekë. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP e ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashikimit të nenit 55 të Rregullave të PP.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 61, të Ligjit Nr. 29, dt. 30.03.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo person që i nënshtrohet këtij ligji është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfardo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme sipas seksionit III “VEPRA INXHINIERIKE”, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e

shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 720.552 lekë dhe për shërbimet e mëparshme të ngjashme sipas seksionit IV “STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT”, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 121.274 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar

dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të Rregullave të PP ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

“Për kontratat e shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ($20\% \times 2,104,567.17 \text{ leke} = 420,913 \text{ leke}$). Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale “Për Mbikqyrje e Kolaudim Punimesh Zbatimi”, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

- a. NP – 1 (Punime gërmimi në tokë)
- b. NP – 2 (Ndërtime civile dhe industriale)
- c. NP – 3 (Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)
- d. NP – 4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- e. N.P – 7 a (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- a. N.S. – 2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)
- b. N.S. – 4A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)

(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe : në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.” , i ndryshuar.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Kriteri dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës.

(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate).

NP – 1 (Punime gërmimi në tokë).

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

NP – 2 (Ndërtime civile dhe industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

NP – 3 (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

NP – 4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P – 7 a (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

N.S. – 2 (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e

kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S. – 4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve që do të mbikëqyren, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të mbikëqyren , që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP – 1	Punime gjurmimi në tokë	Mbikqyrje e: Gjurmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke Gjurmim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir Gjurmim e mbushje dheu me krah per kanale kategori IV, h=1.5m Gjurmim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak. Gjurmime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II, trans.karro dore deri 10 m
NP – 2	Ndërtime civile dhe industriale	Mbikqyrje e objektit: FSHATI MELCAN: Ndërtim pusete komandimi ne linjen e jashtme (pas kaptazhit) Ndërtim depo V=100 m³

		KAPTAZHI KOLANEC: Ndertim puseta ajrimi ne linjen e jashtme (3 puseta) Ndertim puseta shkarkimi (3 puseta)
NP – 3	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada	Mbikqyrje e objektit: FSHATI MELCAN: Rikonstrukcion kaptazhi ekzistues
NP – 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Mbikqyrje e objektit: FSHATI MELCAN: Ndertim rruge sherbimi per linjen e jashtme dhe kaptazhin Punime në rrugë e trotuare dhe rehabilitimi i tyre FSHATI TUMINEC: Punime në rrugë e trotuare dhe rehabilitimi i tyre KAPTAZHI KOLANEC: Punime në rrugë e trotuare dhe rehabilitimi i tyre
NP – 7 a	Ujësjetës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	Mbikqyrje e objektit: FSHATI MELCAN: Ndertim linje e jashtme (nga puseta e kaptazhit deri tek depo e re Melcan) Ndertimi i rrjetit te brendshem FSHATI TUMINEC: Ndertimi i rrjetit te brendshem KAPTAZHI KOLANEC: Ndertim linje e jashtme (nga kaptazhi Kolanec ne puseten e shuarjes Maliq)

N.S. – 2	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre	Mbikqyrje e objektit: FSHATI MELCAN: Instalime hidro-mekanike tek kaptazhi Punime hidro-mekanike ne depo V=100 m3 Instalime hidro-mekanike tek kaptazhi QYTETI MALIQ: Lidhje me kolektor per pallatet me kolona, qyteti Maliq
N.S. – 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Mbikqyrje e: KAPTAZHI KOLANEC: Suvatim murature Boje hidroplastike importi cilesi e I-re

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të punëve që do të mbikëqyren janë në përputhje me procedurën e punës të publikuar me të dhënat si me poshtë: Numri i referencës së procedurës: REF-93644-07-16-2026 dhe objekt “Ndërtim ujësjellësa dhe nënobjekte të furnizimit me ujë dhe përmirësim rrjetesh ekzistuese në Rajonin Korçë”.

Sipas dokumentave bashkangjitur, projektit , specifikimeve teknike , grafikut të punëve.

Për zbatimin e punimeve të këtij projekti, UKRK Sh.A ka të domosdoshme prokurimin e shërbimeve të mbikqyrjes së punimeve në bazë të VKM 354 ,datë 11.05.2016 ku përcaktimi i fondit limit llogaritet sipas:

Seksionit III, grupit tarifor III.c për objektet:

Në fshatin Melçan:

“Ndërtim linje e jashtme (nga puseta e kaptazhit deri tek depo e re Melcan)”; “Ndërtimi i rrjetit të brendshëm”;

Në fshatin Tuminec:

“Ndërtimi i rrjetit të brendshëm”;

Në fshatin Kolanec, qyteti i Maliqit:

“Ndërtim linje e jashtme (nga kaptazhi Kolanec në puseten e shuarjes Maliq)”;

Për lidhjen me kolektor për pallatet me kolona, qyteti Maliq:

“Lidhje me kolektor për pallatet me kolona, qyteti Maliq”

(69% e vlerës totale të preventivit paraprak);

Seksioni III, grupit tarifor II.a për objektet:

Në fshatin Melçan:

“Rikonstruktion kaptazhi ekzistues”;

“Instalime hidro-mekanike tek kaptazhi”;

“Ndërtim pusete komandimi në linjen e jashtme (pas kaptazhit)”;

“Ndërtim depo $V=100\text{ m}^3$ ”;

“Punime hidro-mekanike në depo $V=100\text{ m}^3$ ”;

Në fshatin Kolanec, qyteti i Maliqit:

“Instalime hidro-mekanike tek kaptazhi”;

“Ndërtim puseta ajrimi në linjen e jashtme (3 puseta)”;

“Ndërtim puseta shkarkimi (3 puseta)”;

(14% e vlerës totale të preventivit paraprak);

Seksionit IV, grupit tarifor IV.b, për objektet:

Në fshatin Melçan:

“Ndertim rruge sherbimi per linjen e jashtme dhe kaptazhin”;

“Punime në rrugë e trotuare dhe rehabilitimi i tyre”;

Në fshatin Tuminec:

“Punime në rrugë e trotuare dhe rehabilitimi i tyre”;

Në fshatin Kolanec, qyteti i Maliqit:

“Punime në rrugë e trotuare dhe rehabilitimi i tyre”;

(17% e vlerës totale të preventivit paraprak),

sipas preventivit të punimeve me vlerë totale: 108,331,684.83 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pike tetëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH.

Afatet e ekzekutimit të shërbimeve: brenda një muaji nga data e njoftimit të përfundimit të punimeve. Konkretisht llogaritet të jetë 28 javë sipas procedurës që do të mbikëqyret me objekt “Ndërtim ujësjellesa dhe nënobjekte të furnizimit me ujë dhe përmirësim rrjetesh ekzistuese në Rajonin Korçë”, dhe plus një muaj përgatitja e dosjes së mbikëqyrjes.

1. Mbikëqyria e punimeve përfshin:

1.1. Drejtimin e punëve. Drejtimi i punëve parashikon mbikëqyrjen e vazhdueshme e të kualifikuar të gjithë proceseve të punimeve dhe dokumentacioneve që duhet të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhra për zbatimin me përpikëri e në kohë të kërkesave të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit , të kontratës etj

Për mbikëqyrjen kërkohet prezenca e Mbikëqyrësit në objekt çdo ditë të punimeve për zbatimin e kontratës.

1.2. Mbajtjen e dokumentacionit dhe provat sipas fazave, e cila parashikon kontrollin e mbajtjes së dokumentacioneve nga zbatuesi gjatë kryerjes së punimeve, të punimeve të maskuara dhe të provave të ndryshme, në përputhje me rregullat dhe dispozitat në fuqi.

1.3. Kontrollin dhe likuidimin e punës së kryer, i cili parashikon kontrollin e dokumentimit, verifikimin dhe saktësimin e vëllimeve të punës së kryer dhe materialeve të furnizuara. Parashikon gjithashtu kontrollin e zbatimit të çmimeve njësore (sipas kontratës dhe analizave të veçanta) për kryerjen e likuidimit të shpenzimeve pjesore e përfundimtare.

2. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit të ujësjellësave dhe nën objekteve të furnizimit me ujë, Rajoni Korçë, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit, duke patur parasysh dhe

anën ekonomike të punimeve. Ai është i detyruar të kontrollojë me përgjegjësi cilësinë e punimeve të ndërtimit, e cila duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike, si dhe sipas preventivit të punimeve .

3. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtën dhe detyrën të kryejë shërbimin e përmendur në Kontratë personalisht dhe me përpikmëri duke ndjekur udhëzimet e investitorit porositës.

4. Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit për atë kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjëndjes.

5. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton investitorit për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.

E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin, përbën dokumentacionin e objektit dhe si e tillë, ruhet me çdo kusht.

6. Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.

Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.

7. Mbikëqyrësi i punimeve do të kontrollojë dhe miratojë Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi.

Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të punëve, e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit, si dhe i jepet për likuidim investitorit. Mbikëqyrësi i punimeve ka detyrimin për të kontrolluar dhe firmosur çertifikatën e marrjes përfundimtare të punimeve, pas përfundimit të periudhës së garancisë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Rajoni Korçë.

Njësia e prokurimit: